



Prishtinë: 24.06.2010

Kodi i ZRRE-së: V_253_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK_R_404_05_10

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 16 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Rekomandimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_R_404_05_10** ;
5. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

Në mbledhjen e mbajtur më 24 qershor 2010 nxori këtë:

VENDIM

PRANOHET ankesa e konsumatorit Lutfi Hoxha (lokal "Marc Aurel", shifra e konsumatorit DPR-90043284) nga Prishtina, si në arsyet e paraqitura në këtë vendim.

Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 25.08.2008 ka apeluar përgjigjen e KEK-ut – Departamentit për Konsumator të datës 14.08.2008, lidhur me kontestimin e tij ndaj transferit e borxhit nga shifra DPR – 90023633 në shifrën DPR – 90043284.

- Me datë 06.02.2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut me rastin e kontrollimit të instalimit të njehsorit elektrik kanë përpiluar procesverbalin nr. 0123200 në të cilin është theksuar se është këputur vula (bllomba) për shkak të kontrollimit dhe se gjendja teknike e njehsorit është në rregull.

Provë: Procesverbalin i KEK-ut nr. 0123223 i datës 06.02.2008

- Me datë 06.02.2008 ekipi i autorizuar i KEK-ut me rastin e kontrollimit të instalimit të njehsorit elektrik kanë përpiluar procesverbalin nr. 0123223 në të cilin është theksuar se njehsori elektrik i pavulosur, pa shpenzime dhe se në vend të shifrës DPR – 90023633 janë hapur tre shifra të reja si DPR – 90043284, DPR – 90042621 dhe DPR – 90042620. Duhet theksuar se në këtë procesverbal, ekipi i autorizuar i KEK-ut e ka evidentuar në emër të Afrim Majancit.

Provë: Procesverbalin i KEK-ut nr. 0123223 i datës 06.02.2008

- Me datë 16.02.2008 KEK-u me anë të Urdhër Lejimit / Ngarkimit nr. 15157 e ka ngarkuar shifrën DPR – 90043284 në shumë prej 1705.03 €, në të cilin Urdhër Lejim / Ngarkim ceket se: “RCO1-I-transferi i borxhit nga shifra DPR – 90023633 në DPR – 90043284 sipas procesit të kontrollës nr. 0123223, dt. 06.02.2008”.
Provë: Urdhër Lejimit / Ngarkimit nr. 15157 të datës 16.02.2008
- Pas kësaj konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumator në KEK duke kundërshtuar transferin e borxhit.
- Me datë 14.08.2008 Departamenti për Konsumator në KEK iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke u thirrur në procesin e kontrollës nr. 0123223 të datës 06.02.2008
Provë: Përgjigja e KEK-ut e datës 14.08.2008
- Me datë 25.08.2008 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.
Provë: Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së

DMK në ZRRE duke analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEK-ut dhe konsumatori, ka vërejtur se;

- ✓ Me datë 11.04.2006 konsumatori Lutfi Hoxha ka parashtruar kërkesë për lidhje të re elektrike.
Provë: Aplikacioni për lidhje të re në KEK e datës 11.04.2006
- ✓ Me datë 04.10.2006 ekipi i KEK-ut ka përpiluar formularin e inspektimit të pikë matëse të konsumatorit, me numër njehsori 41832540.
Provë: Formulari i inspektimit të datës 04.10.2006
- ✓ Me datë 04.11.2006 konsumatorit i ka arritur fatura e parë e energjisë elektrike me shifër DPR – 90043284 e me numër njehsori 41832540, pasi që paraprakisht konsumatori është ngarkuar me shërbimin për lidhje të re të cilin konsumatori e ka paguar.
Provë: Transaksionet e konsumatorit
- ✓ Në procesverbalin e KEK-ut nr. 0123223 ekipi i autorizuar i KEK-ut ka përpiluar procesverbalin në emër të Afrim Majancit e me shifër DPR – 90023633, në të cilin është konstatuar se njehsori elektrik është i pavulosur (pa bllobuar), nuk ka shpenzime të energjisë elektrike dhe se në vend të shifrës DPR – 90023633 janë hapur shifra të reja.
Provë: Procesverbali i KEK-ut nr. 0123223 të datës 06.02.2008
- ✓ Konsumatori ka procesin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr. 17726747 në të cilin është marrë gjendja njehsorit në tarifën e lartë dhe ultë dhe se nuk është specifikuar nga ana e KEK-ut se në atë objekt më parë ka ekzistuar një njehsor i ri dhe se ka pasur borxh mirëpo punëtorët e KEK-ut kanë bërë procesin e pranimit të instalimit elektrik.
Provë: Procesi i pranimit të instalimit
- ✓ Shifra e konsumatorit DPR – 90023633 e nr. njehsori 2948079 sipas transaksioneve të konsumatorit shihet se është i regjistruar në emër të konsumatorit Afrim Majancit dhe se borxhi i cili bartur në shifrën e konsumatorit Lutfi Hoxha, butik “Mark Aurel” është i

paraqitur prej mbas mbarimit të luftës e deri në periudhën 02/2008.

Provë: Transaksionet e konsumatorit të shifrës DPR – 90023633

DMK në ZRRE pas analizimit të dëshmive të paraqitura i rekomandon Bordit të ZRRE-së që të **pranojë** ankesën e konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka rishikuar të gjitha dokumentet e paraqitura dhe ka vendosur që ta **pranojë** ankesën e konsumatorit për arsyet e paraqitura në rekomandimin e DMK të ZRRE-së, Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. KEK-u obligohet që të shkarkoj menjëherë konsumatorin me shifër DPR – 90043284 nga borxhi i ngarkuar në shumë prej 1705.03 € të cilën e ka ngarkuar me anë të urdhër lejimit / ngarkimit nr. 15157.
2. KEK-u ka të drejtë të kërkoj informata mbi konsumatorin që e ka krijuar shpenzimin i cili shpenzim vërehet se ekziston edhe sipas transaksioneve të konsumatorit, mirëpo të kërkoj atë borxh në formën e duhur pra në formë gjyqësore e jo ta ngarkoj konsumatorin Lutfi Hoxha

Këshillë Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmbëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

Bordi i ZRRE-së

Dr. Ali Hamiti, kryesues

Theranda Beqiri, anëtare

Përparim Kabashi, anëtar

Blerim Koci, anëtar